



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e IV-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.50/11

Prishtinë, më 27.02.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Munguan: Naser Osmani dhe Xhevdet Neziraj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sylejman Shaqiri, Drejtor gjeneral i RTK-së, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.02.2012;**
3. **Shqyrtimi i kërkesës së Radiotelevizioni të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të Auditimit të performancës së RTK-së,**
I ftuar: Sylejman Shaqiri, Drejtor Gjeneral në RTK;
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, theksoi përmes postës elektronike jeni njoftuar se për mbledhjen e sotëm do të propozohet, një pikë shtesë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-94 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Propozoi që të jetë pika e pestë e rendit të ditës.

Rendi i ditës miratohet njëzëri me plotësime, shtohet pika e re 5: Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-94 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.02.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Radiotelevizioni të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të Auditimit të performancës së RTK-së

Kryetarja, theksoi se RTK në kërkesën drejtuar Kuvendit të cilën kërkesë e ka shqyrtuar Kryesia e Kuvendit dhe e ka ngarkuar komisionin të analizoj dhe të dal me rekomandime për Kryesinë, kërkon nga Kuvendi që të mbulojë shpenzimet për auditimin e performancës së RTK-së. Në bazë të ligji të RTK-së, nenin 26.8 thuhet se bordi i RTK-së e shqyrton dhe publikon më së largu deri më 30 mars raportin vjetor të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin paraprak të përgaditur nga menaxhmenti dhe i cili do të iu nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Është e ditur që ne kemi shqyrtuar planin vjetor të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së për vitin 2012 dhe në fillim për shkak të mospërgatitjes së mirë, e kemi kthyer planin dhe kemi kërkuar që RTK të paraqes një plan më të detalizuar, në të cilin plan RTK nuk ka paraparë mjete për auditimin e jashtëm të pavarur edhe pse ligji i obligon për një auditim të këtyllë. Pyetja për drejtorin menaxhues të RTK-së, është pse nuk janë paraparë mjetet në projeksionet vjetore për auditimin e jashtëm të pavarur? Çështja e dytë ka të bëjë me faktin se RTK financohet nga buxheti i Kosovës, dhe do të duhej që auditimet e performancës sikurse edhe për organizatat tjera buxhetore, të bëhen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Përndryshe kërkesa është parashtruar pa ndonjë cekur shumë të caktuar.

Sylejman Shaqiri, njoftoi se kërkesa është rezultat i një takimi të mbajtur më 16.02.2012 në mes përfaqësuesve ndërkombëtar, zv.kryminisrit, bordit dhe menaxhmentit të RTK-së, në të cilin ndër të tjera është sugjeruar që në RTK të bëhet një auditim i jashtëm i performancës. Si rezultat bordi i RTK-së në bashkëpunim me menaxhmentin kanë vendosura që ti drejtojnë Kuvendit kërkesë për ndarjen e mjeteve shtesë për bërjen e auditimit, duke ditur se buxheti i ndarë për vitin 2012 për RTK-në është i zvogëluar dhe nuk mundemi brenda buxhetit aktual ti mbulojmë shpenzimet. Për këtë arsye nuk kemi planifikuar mjete për auditim dhe duke ditur procedurat e prokurimit dhe ofertave që mund të ofrohen për këtë çështje nuk kemi mundur të paragjykojmë shumën të caktuar.

Kryetarja, theksoi se si komision kemi pasur vërejtje për mënyrën e shpenzimeve, sidomos edhe për tejkalimin e shpenzimeve apo hyrjen në borxhe nga ky medium. Jemi të interesuar që në RTK të bëhet një auditim i performancës për të pasur një pasqyrë më të mirë se si janë shpenzuar mjetet në këtë institucion i cili po financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Kjo do të ndihmonte edhe për të parë arsyeshmërinë e shpenzimit të mjeteve dhe është më lehtë të bëhet edhe planifikimi.

Sali Asllanaj, theksoi se kam një shqetësim pse nuk po bëhet auditimi nga zyra e auditorit të përgjithshëm dhe po kërkohet një auditim i jashtëm. Pra po por krijohet një mosbesim ndaj institucioneve të cilat i kemi themelua vetë, dhe po krijohen shpenzime shtesë të panevojshme. Sipas ligjit, auditori i përgjithshëm është përgjegjës të bëjë auditimin e të gjitha agjencioneve shpenzuese të mjeteve buxhetore dhe propozojë që ti rekomandohet auditorit të përgjithshëm të bëjë një auditim të këtyllë. Duke pasur parasysh faktin se nuk kemi shumën të caktuar dhe është vështirë të vendoset për një shifër të caktuar, dhe vlerësoi se auditimi i performancës të bëhet nga auditori i përgjithshëm.

Hykmete Bajrami, theksoi se kërkesa ka të bëjë me auditimin e performancës dhe nuk po kërkohet të auditohen pasqyrat financiare. Kjo ka dimensione më shumë politike se sa ekonomike dhe ka të bëjë me

kënaqësinë e shikuesve dhe grupeve etnike të Kosovës. Nuk është shumë për tu befasuar pse RTK-ja nuk ka parashikuar mjete për këtë qëllim, dhe ndoshta nuk e ka ditur që do të vjen një kërkesë nga përfaqësuesit e ndryshëm të institucioneve. Kritika e Komisionit për përgatitjen dhe mënyrën e shpenzimit të buxhetit të RTK-së ndoshta janë me vend, por nuk është gjithëmonë fajit RTK-së, sepse vet forma e financimit e ka sjell RTK-në në një pozicion qfarë është sot. Unë jam për gjetjen e një zgjidhje për këtë çështje.

Muhamet Mustafa, theksoi se është e qartë se nuk një auditim i rregullt vjetor, por më specifik dhe , me kërkesën specifike. Duke kuptuar natyrën e kërkesës, ndoshta edhe RTK nuk ka mundur të parashihë mjete për auditim, por mendojë që duhet të gjindet një zgjidhje dhe propozojë që të kërkohej prej auditorit të jashtëm të bëjë një auditim të këtillë.

Kryetarja, theksoi e sot përfundimisht nuk mund të marrim vendim, pasi që nuk kemi edhe ndonjë shumë të caktuar të propozuar, por me që është shumë e rëndësishme performanca e RTK-së, propozoj që grupi punues që ka punuar në shqyrtimin e projektligjit për transmetuesin publik dhe amendamentet e komisionit funksional, të aktivizohet dhe të shqyrtojë kërkesën, ti thërret të gjithë akterët të cilët janë të involvuara në këtë çështje dhe të dal me rekomandime për Komisionin.

Latif Gashi, mbështeti propozimin që të aktivizohet grupi punues, i cili do të shqyrtojë kërkesën që është serioze dhe të dal me rekomandime për Komisionin.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Aktivizohet grupi punues i caktuar për shqyrtimin e Projektligjit për Transmetuesin Publik në Kosovë, të shqyrtojë kërkesën e RTK-së për mbulimin e shpenzimeve të Auditimit të performancës së RTK-së dhe të paraqet raportin me rekomandime për Komisionin për Buxhet dhe Financa.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, njoftoi se në bazë të analizës së bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional, shifet se dispozitat e projektligjit dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Hykmete Bajrami, theksoi se kur është diskutuar në seancë plenare në lexim të parë, është thënë se ky projektligj do të përmban implikime buxhetore në zbatimin e tij, pasi këtu nuk flitet vetëm për Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, por edhe për të gjitha bibliotekat që veprojnë. Është thënë se me ligj do të krijohen borde shumë të vogla në qytete dhe komuna është e panevojshme pasi që krijon kosto shtesë buxhetore. Nëse lihet që varësisht prej mjeteve buxhetore të institucioneve përgjegjëse, e vënë në pikëpyetje zbatimin e këtij ligji sepse varet nga mjetet buxhetore që do të kenë institucionet që ndikohen me këtë ligj.

Kryetarja, sipas deklaratës së departamentit të buxhetit të Ministrisë së Financave projektligji nuk prodhon kosto të drejtpërdrejta buxhetore. Ata kanë rekomanduar që të përfshihet një klauzolë ku thuhet institucionet e ndikuara me këtë ligj, do të bëjnë zbatimin e dispozitave të këtij projektligji, në varësi me mundësitë buxhetore të lejuara, kjo është përfshirë në nenin 12.7 të projektligjit.

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-94 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji nr. 04/L-94 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj